



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 22 dhe neni 20 paragrafi 1 alinea 1 dhe 10<sup>1</sup> nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 54 paragrafi 4 dhe nenin 104 paragrafi 4 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin Up1 nr.08-102 od 01.04.2022 dhe Propozimin Up1 nr.08-102 nga 13.04.2022 nga dr.Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në pajtim me Konkluzën, ark.nr.02-1682/2 nga 15.04.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në seancën e 15-të e mbajtur më 15.04.2022, miratoi:

**V E N D I M**  
**për ndalimin e procedurës së inicuar**  
**për heqjen e lejes për transmetim televiziv**

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj Shoqërisë tregtare radiodifuzive (SHTR) TELEVISION SONCE SHPKPV Prilep, nr.08-141 nga 18.03.2019, me Propozim Up1 nr.08-102 nga 01.04.2022.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë në seancën e 14-të e mbajtur më 04.04.2022., me Konkluzë, ark.nr.02-1524/2 nga 04.04.2022., e miratoi propozimin e Drejtorit të Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, Up1 nr.08-102 nga 01.04.2022.dhe inicoi procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj SHTR TELEVISION SONCE SHPKPV Prilep, nr.08-141 nga 18.03.2019., për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raport ark.nr.05-1473/1 nga 31.03.2022 ishte konstatuar se radiodifuzeri në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të fakturës së lëshuar nga Agjencia, nuk e ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi 5 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar tarifën vjetore për lejen për transmetim televiziv të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë më 04.04.2022.drejtuar radiodifuzerit ishte dërguar një Shkresë Up1 nr.08-102 nga 04.04.2022., i cili ishte njoftuar se nëse nuk paguan tarifën vjetore për leje për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15-të (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, do të miratoi vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv. Shkresa ishte pranuar me rregull nga transmetuesi më 05.04.2022.

Më 13.04.2022.drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit të financave dhe logjistikës, është dorëzuar Njoftim Up1 nr.08-102 nga 13.04.2022. se SHTR TELEVISION SONCE SHPKPV Prilep, më 13.04.2022. bëri pagesë në shumë 1.062.997,00 (një milion gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) denarë,me të cilën transmetuesi tarifën vjetore për lejen për transmetim televiziv e ka paguar plotësisht.

Up1.nr.08-102

Shkup 15.04.2022.



Agjencia për  
shërbime mediatike  
audio dhe  
audiovizuale

rr. Makedonija nr.38  
1000 Shkup  
Republika e  
Maqedonisë  
së Veriut

Tel. + 389 2 3103 400

[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)  
[www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)  
[contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)





**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

Duke u referuar nga sa u tha më lartë, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 22 dhe neni 20 paragrafi 1 alinea 1 dhe 10 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi 4 dhe nenin 104 paragrafi 4 i Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në lidhje me Propozimin Up1 08-102 nga 01.04.2022 dhe Propozimin Up1 nr.08-102 nga 13.04.2022 nga dr.Zoran Trajčevski, Drejtor i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në pajtim me Konkluzën ark.nr.02-1682/2 nga 15.04.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 15-të e mbajtur më 15.04.2022, vendosi të ndërpresë procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u përmend u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuele  
Kryetar i Këshillit**

**Lazo PETRUSHEVSKI d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi transmetuesi mund të ngrëjë padi për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padi për fillimin e kontestit administrativ paraqitet brenda 30 ditëve nga dita e pranimi të vendimit.

**Dorëzuar:**

- Shoqërisë tregtare radiodifuzive TELEVISION SONCE SHPKPV Prilep;
- Udhëheqësit të Shoqërisë tregtare radiodifuzive TELEVISION SONCE SHPKPV Prilep;
- Sektori për përkrahje informative dhe punë të përgjithshme – arkivë;
- Sektori për çështje juridike dhe prokurim publik;
- Sektori i finansave dhe logjistikë; dhe
- Personit e emëruar nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për mbajtjen e Regjistrimit Up1.

<sup>1</sup> Alinetë 8 dhe 9 janë fshirë, shiko: nenin 8 nga Ligji për ndryshimi dhe plotësim të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).